

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“KREA” SHPK**

Ortaku i vetëm themelues:

- **Z. Giorgio Carmine Petrelli**, shtetas italian, i datëlindjes 24.10.1971, lindur në Milano (MI) dhe banues ne Rrugen Fratelli Paglia, 27 Mazzano (BS), Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit italiane Nr. CA77441BY.

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 10.07.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**

***Emri***

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “KREA” SHPK  
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

***Forma***

Shoqëria tregtare “KREA” SHPK ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

***Zyra Qendrore***

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “KREA” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqiperi.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

***Objekti i Veprimtarisë***

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është: Import- eksport te pajisjeve dhe produkteve estetike, produkte kozmetike. Shitje me shumice dhe pakice te pajisjeve te vogla dhe te medha estetike, pajisjeve mjekesore dhe produkteve perkatese. Ngritja e qendrave të ndryshme estetike, klinike. Kryerja e transaksioneve në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme. Kryerja e veprimeve dhe/ose pjesëmarrja në cdo veprim ose aktivitet në perputhje me ligjet e Republikës se Shqiperise, apo cdo veprimtari në lidhje me to dhe cdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm në mënyrë që të përmbushet qëllimi i veprimtarisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar. Të tregtojë të gjitha llojet e pajisjeve, pjesëve të këmbimit si dhe të çdo tjetër mjeti i

GIORGIO PETRELLI 

nevojshëm për ushtrimin e shërbimeve të mësipërme. Të kryeje cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, dhenie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barre hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore të citura me siper. Të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi. Të ofrojë shërbime këshilluese biznesi dhe menaxhimi shoqërive të tjera si kërkime tregu, shërbime profesionale, teknike dhe shkencore si dhe shërbime të tjera këshilluese. Të përvetësojë dhe të shesë pjesëmarrje ose interesa të tjera në korporata, shoqëri tregtare dhe ndërmarrje, të bashkëpunojë me to dhe të drejtojë këto korporata, shoqëri tregtare ose ndërmarrje. Të blejë, të shfrytëzojë për arsye tregtare dhe të shesë pronësinë mbi të drejtat intelektuale dhe/ose industriale, përfshirë know-how, pavarësisht nëse janë apo jo të patentuara, dhe të përvetësojë, të shfrytëzojë për arsye tregtare dhe të shesë prona. Të kryeje çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj dhe janë në favor të qëllimeve si më sipër ose për secilën prej tyre. Pjese kembimi te pjeseve elektronike ose mekanike te pajisjeve estike ose mjekesore, lazer bukurie. Sisteme software, menaxhimi dhe kontrolli i tyre, asistenca ne perditesim e mirembajtje, strategjia web. Shërbime transporti dhe shpërndarje, brenda dhe jashtë territorit shqiptar.

#### **NENI 5**

##### ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

#### **NENI 6**

##### ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare "KREA" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### **NENI 7**

##### ***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "KREA" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

#### **NENI 8**

##### ***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KREA" SHPK është 100.000 (njqindmije) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetem **Z. Giorgio Carmine Petrelli**.

#### **NENI 9**

##### ***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

GIORGIO PETRELLI 



**NENI 10**  
***Administratori***

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është **Zj.Uarda Qevani**.

**NENI 11**  
***Sekreti tregtar***

Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “KREA” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**NENI 12**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**Giorgio Carmine Petrelli**

GIORGIO PETRELLI 